


MANUAL MBI PËRDORIMIN E EDUMEET




Edumeet është një platformë për të mbështetur videokonferencat, dizenuar dhe zhvilluar nga **GÉANT**.

Më poshtë përshkruhen shkurtimisht karakteristikat e kësaj platforme, që do ju vijnë në ndihmë gjatë mësimit online me studentët tuaj.


1. Me anë të një browser google chrome/mozilla etj., ju duhet të aksesoni këtë url: www.vuni.rash.al dhe më pas secili universitet do aksesojë faqen e tij të dedikuar: www.edumeet.umt.rash.al




2. Te hapësira “**Room meet**” do vendosni emrin e dhomës që doni të aksesoni, e cili mund të jetë emri i lëndës apo thjesht një emër çfarëdo që zgjidhet nga ju.




3. Te hapësira “**Your name**” vendosni emrin dhe mbiemrin tuaj, me të cilin do identifikoheni në klasën tuaj online që po ndiqni. Mund të zgjidhni mënyrën e aksesimit të klasës vetëm **audio** (nëse dëshironi vetëm të flisni dhe dëgjoni) ose **audio and video** (nëse dëshironi dhe të jeni me video i pranishëm në klasë)






4. Pas aksesimit të klasës ku ju keni mundësi të shikoni dhe dëgjoni të gjithë anëtarët e tjerë, me anë të elementëve të treguar më poshtë:


- 1) **Lock room** – mbylljen e klasës dhe anëtarë të tjerë nuk mund ta aksesojnë atë
- 2) **Show Participants** – mundësinë për të shikuar numrin e pjesëmarrësve
- 3) **Enter Full screen**
- 4) **Settings** – përshtatje të karakteristikave sipas kërkesave
- 5) **Leave** – për tu larguar nga ajo klasë




5. Nëse klikojmë mbi butonin “**Setting**” ofrohen disa tipe konfigurimesh:




- a) Zgjedhjen e tipit dhe kualitetit të mikrofonit dhe kamerës
- b) Rezolucionin e videos, low, medium, high, very high, ultra




a) Mënyrën e paraqitjes




- a) Përzgjedh numrin e pjesëmarrëve që dëshironi të jenë të dukshëm për ju gjatë zhvilit të mësimit online në klasë




- Në të majtë të ekranit klikojmë butonin e treguar në figurën e mëposhtme. Juve ju jepet mundësia për:




1. Komunikuar me shkrim me pjesëmarrësit në klasën online




2. Për të bërë ndarë me pjesëmarrësit file të ndryshëm




3. Për të parë numrin e pjesëmarrësve aktiv ose pasiv . Këtu mund të bllokojmë mikrofonat e disa ose të gjithë pjesëmarrësve.




a) Bllokimi i mikrofonave mund të bëhet dhe nga faqja e treguar si më poshtë:



b) Opsioni për të bërë **ndarë** ekranin tuaj me të gjithë të pranishmit, duke klikuar **Start screen sharing** e treguar si në figure:



Në tabelën që ju shfaqet mund të zgjidhni njërin nga opsionet më poshtë sipas interesit tuaj dhe më pas klikoni butonin **Share**



Ju mund të largoheni nga klasa duke klikuar butonin **Leave**.

